

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
“CYBER INVEST” SHPK**

AKTII THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "CYBER INVEST" SHPK

KREU I EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMRI I SHOQËRISE

1.1 Sot, në Tiranë më datë 23/02/2023, unë e nënshkruara:

Elda Kozaj, shtetase Shqiptare, lindur në Fier, Shqiperi, më 15.03.1985, dhe mbajtese e ID me nr. personal I55315062E

Themelojë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

"CYBER INVEST" Shpk (Me poshte e quajtur "Shoqeria")

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen: Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga DËSHMORËT E 4 SHKURTIT; Nd. 48; H. 9; Ap. 19.

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqeria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqeria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjisacionit shqiptar, dhe në veçanti: Marketingu i shërbimeve softuerike për menaxhimin, arkivimin, manipulimin dhe analizën e të dhënavë, të përdorshme përmes internetit dhe të ngjashme dhe të ofruara përmes teknologjisë së shpërndarë, cloud (përpunimi dhe manipulimi i të dhënavë me ndihmën e sistemeve të

shpërndara) dhe të ngjashme. ; - zhvillimi, planifikimi, marketingu, gjithashtu në emër të palëve të treta, softuerët, aplikacionet në ueb dhe celularë, zgjidhjet harduerike dhe infrastrukturore për menaxhimin, arkivimin, manipulimin dhe analizën e të dhënave; - ofrimin e shërbimeve të TI-së, arkivimin, menaxhimin, manipulimin dhe analizën e të dhënave; krijimi i indekseve, raporteve dhe llogarive përfundimtare të të dhënave të përpunuara; - shërbime asistence dhe konsulencë për instalimin e softuerit dhe/ose harduerit për menaxhimin, arkivimin dhe analizën e të dhënave; - marrin, transferojnë dhe shfrytëzojnë komercialisht softuer në pronësi ose të licencuar; shfrytëzimi ekonomik në çdo formë teknologje, tekstesh, vizatimesh, markash tregtare, patentash, licencash, grafike, IT dhe produkte intelektuale, gjithashtu me koncesion ose për llogari të palëve të treta, në lidhje me TI-në; - shërbimi i pritjes ("hosting, shpërndarjen e burimeve në hapësira virtuale") të aplikacioneve në internet dhe që do lloj burimi dhe kodi tjetër të pranishëm në internet dhe të ngjashme; - prodhimi, zhvillimi dhe tregtimi i harduerit, përfshirë për palët e treta. Ajo mund të kryejë të gjitha veprimet e luajtshme, me pasuri të paluajtshme, tregtare, industriale dhe financiare të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të korporatës, duke mos mbizotëruar kurrë këtë të fundit dhe me përjashtim të ushtrimit për publikun. Së fundi, shoqëria mund të fitojë aksione dhe aksione, përfshirë aksione, në shoqëri dhe shoqëri të tjera që kanë qëllime të ngjashme ose të ngjashme, ose në çdo rast të lidhura me të vetën, brenda kufijve të ligjit. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha letrat industriale, tregtare, prestigjioze dhe operacionet e pasurive të paluajtshme, të cilat do të konsiderohen nga organi administrative te dobishme dhe te nevojshme për arritjen e qëllimit të korporatës, brenda kufijve të ligjeve në fuqi.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuote:

Elda Kozaj, zoterues 1 (një) kuote me 100% (njeqindperqind) dhe vlerë 100,000 lekë.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar, gjate fases se zhvillimit te aktiviteti te Shoqerise.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, trashegimi, ose me çdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

6.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojë ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te

barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.

**NENI 7
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

7.1 Kuotat e kapitalit te Shoqërisë mund te rëndohen lirisht me barrë siguruese apo te drejta te tjera reale

**KREU III
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**

**NENI 8
ORTAKET**

8.1 Ortaku i vetem shoqerise eshte:

Elda Kozaj, shtetase Shqiptare, lindur në Fier,Shqiperi, më 15.03.1985, dhe mbajtese e ID me nr.personal I55315062E

**NENI 9
ORGANET E SHOQERISE**

9.1 Organet e Shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

**Neni 10
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithe ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 11 ASAMBLEJA E ZAKONSHME

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit finanziar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 12 ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

**Neni 13
Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi**

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

**Neni 14
Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshimin e Statutit;
 - c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
 - d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
 - e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
 - h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
 - j) shperndarjen e fitimeve;
 - k) riorganzimin dhe prishjen e Shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
 - m) çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimit të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

**NENI 15
FINANCIMI I SHOQËRISË**



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'A' or 'M'. To its right is the number '6'.

15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvèc rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejtë të kërkoje nga ortaket e Shoqërisë fondet e nevojshme përritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

Elda Kozaj, shtetase Shqiptare, lindur në Fier, Shqiperi, më 15.03.1985, dhe mbajtese e ID me nr. personal I55315062E

i cili emerohet nga ortaku i vetem i shoqerise për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e me poshtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) percatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe rapporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjeter i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, janë bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhene kryhet te pakten një here ne vit nga eksperte kontabel te certifikuar dhe rapporti i llogaritareve publike te certifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;

16.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoi kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme përritjen e objektit të Shoqërisë përvèc atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'A. Kozaj', is located in the bottom right corner of the page. A small superscript '7' is positioned at the top right of the signature.

**NENI 17
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaket

**KREU V
KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 18
KONTROLLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërkohet në baze të ligjit.

**NENI 19
VITI FINANCIAR**

19.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

**NENI 20
BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit finanziar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finanziar të mbyllur ne mënyrë qëortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividenteëve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

8


**NENI 21
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQUERISE**

21.1 Në rastin e likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**NENI 22
NJOFTIMET**

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit per nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përsone të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruar të kuotës.

**KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 23
LIGJI I ZBATUESHËM**

23.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet ne 2 (dy kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaku themelues, firmoset si me poshte prej tyre.

ELDA KOZAJ

